



Prishtinë: 19.12.2008
Kodi i ZRRE-së: V_141_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh,

1. Mandatin e tij ligjor të përcaktuar në Nenet 15 dhe 26 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë Nr. 2004/9 të amendamentuar me ligjin Nr. 03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 11 e),f),g), 12.4 dhe 18.4 të Ligjit mbi Energjinë Nr 2004/8;
3. Neni 3 të Rregullit mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve);
4. Udhëzimin Administrativ Nr. 06/2007 “Mbi Caqet Indikative për Konsumin e Energjisë Elektrike dhe Ngrohjes nga Burimet e Ripërtrithshme dhe Bashkëprodhimi”; dhe
5. Nenin 5 të Vendimit Nr 05/250 të Qeverisë së Kosovës mbi “Masat nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e ripërtrithshme dhe burimet e energjisë elektrike nga bashkëprodhimi në Kosovë për periudhën 2007-2013”

Në mbledhjen e mbajtur më 19 dhjetor 2008 nxori këtë:

VENDIM

- I. Përcaktohen** tarifat nxitëse (**feed-in**) për prodhimin e energjisë elektrike të prodhuar nga gjeneratorët e erës.

Arsyetim

1. Vendimi bazohet në:
 - Raportin Konsultativ të ZRRE-së mbi Shqyrtimin Tarifës nxitëse (Feed-In) për energji elektrike të prodhuar nga era, lëshuar më 27 nëntor 2008.

Struktura e tarifës nxitëse feed-in duket si vijon:

<i>Tarifa nxitëse Feed-in</i>	<i>Tarifa (eurocent/kWh)</i>
Për kapacitete gjeneruese me paisje të reja	8.4



2. Këto tarifa vlejnë për një periudhë 10 vjeçare.
3. Vendimi nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe;
4. Vendimi hyn në fuqi datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqesë ankesë në Gjykatën Kompetente në Prishtinë brenda 14 ditëve nga data e miratimit dhe publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Dr. Nysret Avdiu, Anëtar